



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 73-të, të mbajtur më 18.08.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi me numër 12-5228/1 i datës 25.05.2022, HIDHET POSHT.  
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.  
Denoncimi të dorëzohet për veprim kompetent në Komisionin Rregullator për Banim të RMV-së.  
Lënda me numër 12-5228 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.  
Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-5228/1 të datës 25.05.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Akuzat e bëra në denoncim kanë të bëjnë me dyshimet për funksionimin e paligjshëm të një administratori rezidencial ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Me mbikëqyrjen mbi përmbajtjen e denoncimit, KSHPK-ja vlerësoi se nuk kishte elementë për trajtimin e duhur në rastin e caktuar. Autoriteti kompetent për shqyrtimin e pretendimeve të denoncimit është Komisioni Rregullator i Banimit të RMV-së, që është arsyeja pse KSHPK-ja vendosi t'ia përcjellë kërkesën autoritetit.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri të:  
Parashtruesi i denoncimit  
- Komisioni Rregullator i Banimit të RMV-s

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: S. P. D.

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska

